

VENDIM
Nr. 710, datë 12.10.2016

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESAT DHE KRITERET PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË OPERATORIT TURISTIK”**

(Ndryshuar me VKM nr. 229, datë 17.4.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 51, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen *Ministria e Turizmit dhe Mjedisit* dhe *Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

RREGULLORE
**PËR KËRKESAT DHE KRITERET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
OPERATORIT TURISTIK**

Neni 1

Objekti

Në këtë rregullore përcaktohen kërkesat dhe kriteret të cilave u nënshtrohen të gjithë personat fizikë a juridikë, sipërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë nëpërmjet platformave elektronike që licencohen për ushtrimin e veprimtarisë, si operator turistik, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë si operator turistik

(Ndryshuar togfjalësh në shkronjën “dh” të pikës 4 me VKM nr. 229, datë 17.4.2025)

Personi fizik ose juridik, që ushtron veprimtarinë, si operator turistik, duhet të zbatojë kërkesat e mëposhtme:

1. Ambienti i ushtrimit të veprimtarisë nuk mund të jetë më pak se 16 m² dhe duhet të jetë i pajisur me pajisje të përshtatshme pune, përfshirë tavolinën e punës, karrige, pajisje informatike dhe të ketë akses në internet, akses në rrjetin telefonik etj.

2. Nëse në mjedisin e punës punojnë më shumë se dy punonjës, sipërfaqja minimale e detyrueshme duhet të jetë të paktën 4 m² mbi sipërfaqen minimale të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, për çdo punonjës shtesë.

3. Në rastin kur subjekti e ushtron veprimtarinë në më shumë se një mjedis pune, në secilin prej tyre duhet të përmbushë kriteret e parashikuara për operatorin turistik.

4. Nëse subjekti ofron shërbime në mënyrë të drejtpërdrejtë te klientët fundorë, duhet që:

a) në një vend të dukshëm, në pjesën e jashtme të mjedisit të punës, ku ushtron veprimtarinë, të vendosë një tabelë me emrin e subjektit dhe adresën e tij;

b) në hyrje të mjedisit të punës, ku ushtron veprimtarinë, të vendosë një tabelë me orarin e punës;

c) në një vend të dukshëm në brendësi të mjedisit të punës, ku ushtron veprimtarinë, të vendosë

licencën e miratuar nga struktura përgjegjëse;

c) në një vend të dukshëm të afishojë dhe të informojë klientin në lidhje me kushtet, përmbajtjen dhe çmimin për çdo shërbim individual;

d) të sigurojë një mënyrë të përshtatshme për depozitimin e ankesave nga klientët, duke përfshirë, por pa u kufizuar, një libër ankesash në mjedisin e punës, adresë elektronike për pritjen e ankesave etj. Dhe, brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës, të japë një përgjigje me shkrim;

dh) në përfundim të afatit 3-ditor për shqyrtimin e ankesës nga operatori turistik, parashikuar në shkronjën “d”, të pikës 4, të këtij neni, klienti mund të paraqesë ankesë *pranë strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit*.

5. Për shërbimin që ndërmjetëson, operatori turistik siguron nënshkrimin e një kontrate midis klientit, ofruesit të shërbimit që ushtron aktivitetin sipas legjislacionit në fuqi dhe/ose operatorit turistik, kontratë e cila ruhet nga palët nënshkruese dhe duhet të dokumentojë organizimin e shërbimit.

6. Çdo paketë udhëtimi, e përgatitur nga operatori turistik, kur shitet te klienti fundor nga operatori turistik, në mënyrë të drejtpërdrejtë në mjedisin e punës ose nëpërmjet komunikimit elektronik, shoqërohet me kontratën e lidhur mes klientit dhe operatorit turistik, sipas legjislacionit në fuqi, e nënshkruar nga palët në formën e printuar ose sipas parashikimeve të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”.

7. Kontrata e paketës së udhëtimit shoqërohet gjithmonë me kontratën e sigurimit që mbulon përgjegjësinë e operatorit turistik ndaj palëve të treta për dëmet e shkaktuara si rezultat i mospërmbylljes së detyrimeve, përfshirë rastet e paafetësisë paguese dhe falimentimit.

8. Operatori turistik detyrohet të garantojë klientin se, në rast falimentimi, pas lidhjes së kontratës, do të rimburojë plotësisht vlerën e paguar nga ana e klientit.

Në rast falimentimi të operatorit turistik gjatë zbatimit të kontratës, ky i fundit detyrohet që, përpos rimbursimit të vlerës monetare, të rikthejë klientin në pikën e nisjes.

9. Operatori turistik është i detyruar që, përgjatë organizimit të një pakete udhëtimi dhe ekskursioni, për më shumë se 10 persona, duhet të angazhojë gjatë tij të paktën një shoqërues udhëtimi dhe përgjatë vizitave në vende të vizitueshme, një udhërrëfyes turistik të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi.

10. Operatori turistik mbron të dhënat personale të administruara prej tij në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, përfshirë identitetin, adresën, vendin, kohën e udhëtimit, qëndrimin dhe çmimin, dhe nuk i përhap të dhënat te palë të treta, pa pëlqimin paraprak të shprehur të klientit, me përjashtim të rasteve kur detyrohet nga ligji ta japë këtë informacion tek organet përkatëse shtetërore.

Neni 3

Përfaqësimi i operatorit turistik

(Ndryshuar me VKM nr. 229, datë 17.4.2025)

1. Operatori turistik përfaqësohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga përfaqësuesi ligjor (administratori) dhe drejtuesi teknik, të cilët përveç kritereve të përcaktuara në shkronjat “b” e “c”, të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) përfaqësuesi ligjor (administratori) dhe drejtuesi teknik të vërtetojnë se kanë pasur eksperiencë pune në veprimtari të tilla turistike, si: agjenci udhëtimi, strukturë akomoduese, operator turistik, operator turistik detar, udhërrëfyes turistik apo dhe në aktivitete të tjera të lidhura me turizmin;

b) drejtuesi teknik të jetë i punësuar vetëm në një operator turistik, në cilësinë e drejtuesit teknik;

c) drejtuesi teknik, për nevojë të ushtrimit të veprimtarisë së tij, të vërtetojë se zotëron të paktën një gjuhë të huaj nëpërmjet një dëshmie, certifikate, diplome ose një dokumenti të ngjashëm me to, lëshuar nga subjekti i certifikuar nga ministria përgjegjëse për arsimin për organizimin e testeve ndërkombëtare, në nivelin B2, ose nga institucioni i arsimit të lartë publik apo privat, që është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, për të ofruar programe të akredituara të

gjuhëve të huaja, me vlerësim mbi/edhe notën 7 (shtatë).

2. Përfaqësuesi ligjor dhe drejtuesi teknik, në çdo rast, janë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje.